

STATUTI I SHOQËRISË dhe AKT THEMELIMI

SOLAR SPACE STB SHPK

Sot me date 25/09/2022, ne perputhje me:

- Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare";
- Ligjin nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit"

Z. **Darien XHINDOLI**, shtetas Shqiptar, i lindur me 20.07.1979 ne Lushnje dhe banues ne Lushnje, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit me nr.personal **H90720230J** themelon ne cilesine e Ortakut te Vetem, Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **SOLAR SPACE STB SHPK** me permbajtjen si me poshte vijon:

KAPITULLI I

FORMA; KOHËZGJATJA; ZYRA QENDRORE; OBJEKTI

Neni 1: Forma Juridike

Shoqeria **SOLAR SPACE STB SHPK**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e themeluar nga personi fizik i siperpermendur, i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkuara

Neni 2: Kohëzgjatja

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Kohëzgjatja e shoqerise është me afat të pakufizuar qe fillon prej dates se regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar, pranë Qendres Kombetare te Biznesit (me poshte referuar si QKB).

Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të pezulloje ose mbyllë veprimtarinë e saj kur e shoh të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

Neni 3: Zyra Qendrore

Zyra Qendrore e Shoqerise ndodhet ne adresen: **Lagjia Gafurr Muço, Zona industriale, Nr. 1, Pasuria me Nr. 13/131, Zona kadastrale Nr. 8572, Lushnje.**

Gjate ushtrimit aktivitetit te saj, shoqeria mund te hape dege ose zyra perfaqesimi si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 4: Objekti

Shoqeria do te kete per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

Të zhvillojë aktivitet në fushën e studim projektim, supervision dhe ndërtim linjash për energjinë elektrike dhe telekomunikacionin, nënstationet elektrike T. L/T. M/T. U, centrale dhe hidrocentrale. Të zhvillojë aktivitet në fushën e mirëmbajtjes, remontit profilaktik të mesëm e kapital të transformatorëve të llojeve të ndryshëm. Të zhvillojë aktivitet në fushën e prodhimit të materialeve elektrike. Të zhvillojë aktivitet në fushën e tregtimit të karburanteve me pakicë. Të zhvillojë aktivitet në fushën së ndërtimit. Për punime ndërtimi, shërbime mirëmbajtje e riparim të aseteve të infrastrukturës energjetike industriale të TL dhe TM, punime hidraulike, elektrike, punime hekuri dhe çdo punim tjetër që ka të bëjë me ndërtime e montime. Të zhvillojë aktivitet në fushën e import eksportit dhe tregtimit me shumicë e pakicë të makinerive e pajisjeve elektrike dhe elektronike për përdorim industrial, produkteve dhe materialeve të ndryshme të mobilierisë. Të zhvillojë aktivitet në fushën e tregtisë së automjeteve të të gjitha tipave me shumicë e pakicë, në fushën e shërbimit të transportit të mallrave dhe udhëtarëve si brenda dhe jashtë vendit, shërbimit ndaj mjeteve të transportit duke përfshirë gjithë sektorin e mekanikës, 2 servisit të autove etj. Të zhvillojë aktivitet në fushën e marketingut, si të shërbimeve marketing; realizim reklamash, fletëpalosje prezantimi, katalogë produktesh e ecurie të bizneseve e deri tek realizimi i studimeve marketing si; studime tregu, studime klientele, studime burimesh e deri tek realizimi i Plan bizneseve në fusha të ndryshme. Të zhvillojë aktivitet në fushën e tregtisë me shumicë dhe me pakicë, import eksport i të gjitha mallrave industriale, hidrosanitare, artikuj të konsumit të gjere, veshjeve konfeksioneve të ndryshme për të rritur e fëmijë, pajisje elektroshtëpiake, artikuj kozmetike, bimë medicinale, prodhime e punime të lëndëve të drurit, tregtim mobiliesh. Të zhvillojë aktivitet në fushën e tregtisë me shumicë dhe me pakicë, import eksport si dhe prodhimi në vend i të gjitha mallrave ushqimorë, bujqësore, blegtorale, artikuj të konsumit ushqimor, shërbimeve të kuzhinës, bar restoranteve, fast fondeve si dhe produkteve gjysmë të gatshëm ushqimor, etj. Hapja e pikave të servisit, lavazheve, parkime, bar restorante, hoteleri, agjenci shitblerje, agjenci turistike e komisionere, si dhe çdo aktivitet tjetër që ka lidhje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me aktivitetet e lartpërmendura dhe që shërbejnë për përmbushjen e objektit të veprimtarisë. Veprimtari import, eksport dhe tregtim te energjise elektrike.

- a) Implementimi dhe menaxhimi i projekteve gjeneruese (fotovoltaike, eolike, hidrike) te energjise elektrike, te cilat shfrytezojne burimet e rinovueshme te energjise si dielli, era, uji, si dhe i veprave te tyre ndihmese.
- b) Aplikimi dhe marrja nga qeveria shqiptare apo institucionet pergjegjese te shtetit shqiptar i te gjitha lejeve, licencave dhe autorizimeve paraprake/perfundimtare, te cilat mundesojne zhvillimin e ketyre aktiviteteve ne menyre te qete dhe ne perputhje me kuadrin ligjor ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.
- c) Shitja me shumicë dhe pakicë e energjisë elektrike tek operatorët, furnizuesit, tregtarët, konsumatorët e energjisë elektrike (vendas apo te huaj), si dhe ne Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike, apo Bursat e tjera jashtë vendit.

-Gjithashtu, per te realizuar objektivat e saj, shoqeria mund te ndermarre e te zhvilloje edhe cdo lloj aktiviteti tjetër te ligjshem ne territorin e Republikës se Shqiperise dhe qe siguron te ardhura dhe fitime te ligjshme.

- Objekti i shoqerise mund te zgjerohet apo zvogelohet ne varesi te interesave te shoqerise dhe ne baze te vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve.

KAPITULLI II KAPITALI

Neni 5 : **Kapitali themeltar**

5.1. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10.000 lekë i formuar ne mase te plote nga kontributi i ortakut dhe i ndare ne nje kuote me vlere nominale sipas ndarjes se meposhtme. Cdo kuote njesie ka te drejten e nje vote. Pjesmarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij si me poshte:

Ortaku themelues, **Darien XHINDOLI**, zoterues i nje kuote me vlere te pergjithshme 10.000(dhjete mije) leke, qe perben 100% te kapitalit themltar te shoqerise.

KAPITULLI III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 6

Organet kryesore drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve
- Administratori

Neni 7

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve Te drejtat dhe detyrimet

7.1.Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

7.2. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:

- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
- dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;
- i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji

7.3. Nëse shoqëria zotërohet nga një ortak, të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme së Ortakeve

8.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë drejtuar ortakeve të shoqërisë. Njoftimi me shkresë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

8.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 10.1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 9

Kuorumi

a) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

b) Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht dhe votojnë me shkresë.

c) Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 10

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 11 **Administrimi**

- 11.1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë, të cilët duhet të jenë detyrimisht ortake të saj. Afati i emërimit të administratorit është **5 vjet**, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit
- 11.2. Administrator i parë i shoqërisë është **Z. Darien XHINDOLI, i cili zgjidhet për një periudhë 5 vjeçare.**
- 11.3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorët në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

Neni 12 **Kompetencat e administratorëve**

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Neni 13 **Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, kompetente do të jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor nën juridiksionin e se cilit shtrihet aktiviteti i shoqërisë.

Neni 14

Largimi i ortakut

Ky statut nuk mund të përjashtojë apo të kufizojë të drejtën e ortakut për t'u larguar nga shoqëria dhe të drejtën e shoqërisë për të përjashtuar ortakun ne baze te dispozitave perkatese te legjislacionit tregtar ne fuqi.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ne cdo rast, palet do ti referohen dispozitave ligjore te ligjit 9901, date 14.4.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" per zgjidhjen e ceshtjeve konkrete dhe te detajuara te cilat nuk jane permendur specifikisht ne kete akt themelimi personi juridik.

Ky statut u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi u miratua ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i Vetem i Shoqerise, u nenshkrua rregullisht nga ai pa asnje verejtje.

ORTAKU I VETEM THEMELUES

Darien XHINDOLI

Darien Xhindoli

